

Komentet e Institutit GAP për Projektligjin për financat e pushtetit lokal

Koment i përgjithshëm

Instituti GAP e përkrah iniciativën e ndarjes së burimeve të financimit për çështje sociale nga granti i përgjithshëm. Në anën tjetër, duke qenë se komunat do të mbesin të varura financiarisht nga grantet qeveritare, ky projektligj nuk e adreson problemin e pavarësisë financiare të komunave dhe krijimit të nxitësve që komunat të mbledhin më shumë të hyra vetanake.

Neni 8 . Granti i Përgjithshëm

Me qëllim të rritjes së transparencës për burimin e financimit të komunave, në ligj duhet të specifikohet se Ligji për buxhetin çdo vit duhet të përmbajë një tabelë e cila e zbërthen financimin nga Granti i përgjithshëm për secilën komunë në bazë të kriterëve nga: a) shuma fikse; b) numrin e popullsisë; c) madhësinë gjeografike; d) numrin e popullsisë nga komuniteti jo shumicë, dhe e) faktori i qëndrueshmërisë së komunave. Kjo gjithashtu u mundëson deputetëve dhe akterëve tjerë të informohen dhe monitorojnë sa po përfitojnë komunat burime shtesë si pasojë e komuniteteve pakicë.

Neni 9. Ndarja e Grantit të Përgjithshëm në rast të bartjes së kompetencave

Në këtë nen duhet të precizohet se fondet e ndara për kompetenca shtesë duhet të jenë në përputhje me vlerësimin e kostos financiare të kostuar në ligjin i cili i jep ato kompetenca shtesë për komuna. Duke marrë parasysh se Qeveria e Kosovës ka pasur raste kur ka marr edhe vendime të kunderligjshme financiare (shembull rasti i faljeve të borxheve) nuk duhet të lihet kompetencë ekskluzive e qeverisë që të vendos për vlerën shtesë të grantit të përgjithshëm. Kjo ose duhet të shkojë përmes Kuvendit të Kosovës ose me ligj të precizohet që granti i përgjithshëm rritet sakt sa është vlerësuar kostoja financiare e kompetencave shtesë në ligjin përkatës.

Neni 10

Sugjerohet të largohet në tërësi ngase nuk është e nevojshme që Ligji për Financat e Pushtetit Lokal të flas për ndarjen ose bashkimin e dy apo me shumë komunave. Në asnjë ligj tjetër duke përfshirë edhe atë të vetëqeverisjes lokale nuk parashihet mundësia e bashkimit të dy apo më shumë komunave.

Neni 14

Sugjerohet të plotësohet me futjen si të hyra komunale nga taksa në: lejet e ndërtimit; taksa nga rrënimi i ndërtimeve pa leje dhe taksa për automjetet motorike.

Neni 26. Të hyrat nga burimet tjera

Në kuadër të këtij neni duhet të njihet edhe çështja e financimit të katër komunave në veri të vendit nga ashtuquajtuari “Fondi për zhvillim”. Kjo mund të rregullohet duke e precizuar saktë “Fondin për zhvillim” si burim të hyrave për këto komuna ose të specifikohet se lejohet financimi i komunave si

pasojë e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare. Të hyrat nga “Fondi për zhvillim” nuk janë pjesë e ndonjë ligji në fuqi.

Ndikimi financiar

Në dokumentin konsultues duhet të bëhet një vlerësim se sa do të jetë ndikimi financiar për secilën komunë si pasojë e këtij projektligji. Është me interes të dihet se sa bien të hyrat nga granti i përgjithshëm dhe sa do të jenë të hyrat nga granti për shërbime sociale për secilën komunë.

Instituti GAP mbështetet nga:

